



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave Administracije
Ministry of Local Government Administration*

RAPORT I ANALIZËS EX-POST

PËR MEKANIZMAT E DEMOKRACISË LOKALE

Dhjetor, 2023

Raport i analizës ex-post për mekanizmat e demokracisë lokale, i miratuar me Vendimi e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.22/180 dt.27.12.2023

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
I. HYRJE	6
II. PËRSHKRIMI I LIGJIT QË DO TË VLERËSOHET DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR	10
III. REZULTATET E VLERËSIMIT	12
III. 1. Identifikimi i sfidave apo efekteve pozitive gjatë zbatimit të dispozitave në lidhje me informimin publik dhe konsultimeve publike	12
Takimet publike gjithpërfshirëse me qytetarë	12
Konsultimet publike për projekt-akte dhe dokumente të politikave	14
Informimi për aktivitetet e komunës	18
E drejta për qasje në dokumentet zyrtare	21
Miratimi i legjislacionit sekondar në fushën e transparencës komunale.....	24
III. 2. Identifikimi i sfidave apo efekteve pozitive gjatë zbatimit të dispozitave në lidhje me të drejtën e peticionit, iniciativave qytetare, referendumit dhe iniciativën për largimin e kryetarit	25
E drejta e peticionit	25
Iniciativat qytetare	26
Iniciativa për largimin e kryetarit.....	27
Referendumi lokal.....	28
Komitetet konsultative	29
Themelimi i Këshillave të Fshatrave, Lagjeve Urbane dhe Vendbanimeve.....	31
IV. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE.....	33
V. REKOMANDIMET	36
VI. SHTOJCA 1 - Pyetësi me komuna.....	38
VI. SHTOJCA 2 - Lista e referencave	40
VI. SHTOJCA 3 - Lista e shkurtesave.....	42

Institucioni propozues	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Titulli i raportit të vlerësimit ex-post	Raporti i Analizës Ex-Post të Mekanizmave të Demokracisë Lokale
Personi kontaktues	Manushaqe Mucaj, MAPL
Grupi punues	<p>Jeton Qela, MAPL, kryesues i Grupit Punues</p> <p>Manushaqe Mucaj, MAPL</p> <p>Erblin Hetemi, MAPL</p> <p>Besim Murtezani, MAPL</p> <p>Erblin Hetemi, MAPL</p> <p>Sibel Gutiq, MAPL</p> <p>Mergim Neziraj, MAPL</p> <p>Bekim Salihu, Instituti GAP</p> <p>Jehona Ademi, MFPT</p> <p>Shqipe Arifaj, AKK</p>
Data	Dhjetor 2023

Ky raport përmbush në mënyrë të kënaqshme standardet e cilësisë së vlerësimit.

Nënshkrimi:

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Raporti Ex-Post i dispozitave ligjore që rregullojnë mekanizmat e demokracisë ligjore synon të bëjë një vlerësim të zbatimit, pajtueshmërisë dhe rezultateve të arritura gjatë zbatimit nga ana e komunave të të gjithë mekanizmave të demokracisë lokale. Rezultatet e këtij vlerësimi është të informoj politikat publike të Qeverisë së Kosovës në përmirësimin dhe avansimin e këtyre mekanizmave në të ardhmën, përmes informatave të besueshme dhe zyrtare. LVL ka hyrë në fuqi në vitin 2008, dhe që nga kjo kohë deri më tani nuk ka pas asnjë ndryshim të kësaj kornize ligjore. Andaj një vlerësim i rezultateve të arritura të dispozitave që rregullojnë mekanizmat lokal të demokracisë është shumë i domosdoshëm.

Grupi Punues ka kryer një vlerësim ex-post të dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) në Republikën e Kosovës, me fokus kryesor në mekanizmat e demokracisë lokale, përkatësisht nenet 68-73 dhe nenit 34 të LVL. Qëllimi i vlerësimit ishte të konstatojë zbatueshmërinë e këtyre dispozitave dhe veprimet e institucioneve përgjegjëse për të përmirësuar zbatimin e tyre. Raporti është hartuar në bazë të Manualit për Vlerësimin Ex-Post të Akteve Juridike. Analiza është përqendruar në dy lloje të vlerësimeve: a. vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë, si dhe b. vlerësimin e performancës. Metodologjia e ndjekur ka përfshirë identifikimin e përdorimit të dispozitave në praktikë, integrimin e tyre në aktet nënligjore, dhe analizën e mekanizmave për zbatimin efektiv. Për të marrë një pasqyrë më të qartë të zbatimit të dispozitave të LVL që rregullojnë demokracinë lokale, dhe të dhënave nga komunat është hartuar dhe shpërndarë më komunat një pyetësor si dhe janë konsultuar raporte, analiza, të dhëna zyrtare dhe publike që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave ligjore që janë pjesë e analizës ex-post.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë se dispozitat e LVL dhe aktet nënligjore të hartuara sigurojnë një bazë ligjore solide për rregullimin e transparencës, takimeve publike dhe konsultimeve komunale në përgjithësi. Megjithatë, vlerësohet se, përkundër përpjekjeve për zbatim nga komunat të këtyre dispozitave ligjore, pjesëmarrja e qytetarëve në takimet publike mbetet e ulët, ndërsa shfrytëzimi i praktikave të ndryshme komunikimi nuk ka rritur interesimin e tyre.

Në fushën e peticioneve dhe iniciativave qytetare, vërehet nevoja për ndryshime në zbatimin e LVL. Kërkesa për largimin e kryetarit përballet me sfida, duke patur një kuotë të lartë të votuesve si kriter, ndërsa ende nuk ka një bazë ligjore të mjaftueshme për

mekanizmin e iniciativës për largimin e kryetarit, edhe përkundër miratimit të Udhëzimit Administrativ për zbatimin e kësaj iniciative.

Në lidhje me referendimet lokale, mungon një kornizë ligjore për organizimin e tyre, dhe ky mekanizëm demokratik ende nuk është përdorur nga komunat. Në sektorin e komiteteve konsultative dhe këshillave lokale, baza ligjore ekziston, por efektiviteti dhe transparenca e punës së tyre mbetet shumë e ulët. Vetëm disa komuna kanë komitete konsultative, dhe roli i tyre në hartimin e politikave lokale është i kufizuar. Këshillat lokale nuk arrijnë të plotësojnë kriterin ligjor për takime vjetore dhe pjesëmarrje të lartë të grave.

Për të gjitha gjetjet janë hartuar edhe rekomandime konkreteve. Në përmirësimin e transparencës, takimeve dhe konsultimeve publike, rekomandohet avancimi i praktikave të mira dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve përmes fushatave të ndërgjegjësimit dhe materialeve informative. Gjithashtu, rekomandohet një përdorim më efikas i mjeteve elektronike dhe platformave për të rritur pjesëmarrjen dhe interesin e qytetarëve në takime dhe konsultime.

Lidhur me petitionet dhe iniciativat qytetare, vërehet nevoja për plotësim të legjislacionit dhe rregullime të qarta në shqyrtimin e tyre nga komunat. Rishikimi i kuotës së nevojshme për procedurat e largimit të kryetarit është një rekomandim për përmirësimin e këtij mekanizmi. Në anën tjetër, duhet të shqyrtohen më drejt përpjekjet për plotësimin e bazës ligjore që do të mundësonte dhe sqaronte procedurën e iniciativës për largimin e kryetarit.

Për referendimet lokale, rekomandohet të krijohet kornizë ligjore dhe të ofrohet mbështetje ndaj komunave për përdorimin e mekanizmave të referendumeve për të konsultuar qytetarët në çështje të caktuara.

Në fushën e komiteteve konsultative dhe këshillave lokale, rekomandohet që komunat të krijojnë këto komitete për të mbështetur punën e komunave dhe rekomandohet identifikimi i praktikave për pjesëmarrje të diversifikuara dhe përfaqësim të grupeve të papërfshira, përfshirë gratë.

I. HYRJE

I.1. Konteksti historik i rregullimit ligjor të mekanizmave të demokracisë lokale

Periodha e zhvillimit të vetqeverisjes lokale dhe promovimit të mekanizmave të demokracisë lokale në nivel ligjor pas luftës ndahet në dy pjesë kryesore: periodha e administrimit ndërkombëtar, pra UNMIKUT (1999-2008), dhe periodha pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisje Lokale (LVL) (2008-tutje).

Gjatë periudhës së parë, në mungesë të një ligji, rregulloret e UNMIK-ut u përdorën për rregullimin e parë juridik të qeverisjes lokale. Kjo periudhë karakterizohet me prezencën e administratorëve ndërkombëtarë komunalë në komuna. Rregullorja fillestare për funksionimin e komunave ishte ajo për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, e nxjerrë më 11 gusht të vitit 2000. Sipas kësaj rregullore, komunat ishin institucione përkohësisht autonome, ku gradualisht do t'i transferoheshin kompetencat nga UNMIK-u tek autoritetet vendore. Rregullorja Nr. 2000/45 për funksionimin e komunave në Kosovë i përkufizonte ato si njësitë themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale.

Në linjë të përgjithshme aktet juridike që udhëhoqën veprimtarinë e pushtetit lokal përcaktonin parimet e transparencës dhe demokracisë lokale. Në seancat e kuvendeve komunale dhe organeve të tjera, qytetarëve dhe përfaqësuesve të mediave garantohej pjesëmarrja, me përjashtim të rasteve kur informacionet mund të shkaktonin rrezikonin zbulimin e të dhënave konfidenciale, personale apo të lidhura me procese gjyqësore. Rregullat e pjesëmarrjes së publikut në mbledhjet e organeve komunale ishin të detajuara në statutin e komunave

Për sa i përket demokracisë lokale, mekanizmat kryesorë përmes të cilëve qytetarët shprehnin drejtpërdrejtë pushtetin e tyre përfshinin tubimet publike dhe peticionet. Secila komunë duhet të organizonte të paktën dy herë në vit tubime publike, duke lejuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe informimin e tyre nga përfaqësuesit e komunës. Po ashtu, çdo person fizik apo juridik kishte të drejtë të paraqiste peticion për çështje që lidheshin me veprimtarinë e komunës. Rishqyrtimi i peticionit zhvillohej në përputhje me procedurat e përcaktuara nga statuti dhe rregullat e komunës.

Me hyrjen në fuqi të LVL me 19 qershor të vitit 2008 fillon periodha tjetër e rregullimit ligjor të komunave. Përmes këtij ligji, u formësuan themelet e një sistemi të vetqeverisjes lokale, ku komunat janë njësitë themelore të vetqeverisjes lokale. Përpos përcaktimit të rregullave për kompetencat e komunave, janë definuar edhe dispozitat që promovojnë mekanizmat e demokracisë lokale. Kështu, LVL përcakton këto mekanizma kryesor të demokracisë lokale:

1. Informimi publik dhe konsultimi;
2. E drejta e peticionit;
3. Iniciativat qytetare;
4. Referendumi;
5. Procedura e shkarkimit të kryetarit;
6. Komitetet konsultative.

Nga hyrja në fuqi e LVL, janë hartuar një numër i madh i akteve nënligjore, si nga MAPL, ashtu edhe nga komunat për të rregulluar në mënyrë të detajuar aspekte të ndryshme në lidhje me transparencën komunale dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Për më tepër, MAPL dhe komunat kanë ndërtuar mekanizma të ndryshëm, qoftë për monitorimin e zbatimit të obligimeve ligjore në raport me demokracinë lokale, poashtu edhe në implementimin e mekanizmave në praktikë.

I.2. Konteksti i vlerësimit ex-post

Që nga hyrja në fuqi e LVL, nuk ka pasur asnjë ndryshim të këtij ligji, përfshirë këtu edhe dispozitat që hyjnë në fushëveprimin e analizës ex-post. Megjithatë, baza ligjore është plotësuar me akte nënligjore të nxjerra nga MAPL dhe komunat, për të vënë në funksion këto mekanizma. Në anën tjetër, janë shtuar përpjekjet e nivelit qëndror, lokal, organizatave të shoqërisë civile, mediave, komunitetit dhe donatorëve ndërkombëtar për të mbështetur zbatimin në praktikë të këtyre mekanizmave.

Periodha e gjatë e zbatimit të LVL, që arrin mbi 14 vjet, jep mundësi për një vështrim të gjërë dhe të hollësishëm mbi efektet dhe rezultatet e ligjit. Kjo periudhë e gjatë shfrytëzohet për të analizuar thellësisht se si dispozitat e LVL janë implementuar dhe monitoruar në praktikë gjatë kohës, duke krijuar një perspektivë të qëndrueshme mbi zhvillimin dhe ndikimin e tij në sistemin e vetëqeverisjes lokale.

Në përfundim, vlerësimi ex-post i LVL ka për qëllim të përdorë këto arsye për të ofruar një analizë të hollësishme dhe të saktë të zbatimit të ligjit, identifikuar çështje kryesore, dhe propozuar rekomandime për përmirësimin e tij në të ardhmen.

I.3. Qëllimi dhe fushëveprimi i vlerësimit

Raporti Ex-Post për mekanizmat e demokracisë lokale në Kosovë ka për qëllim të ofrojë një analizë të thelluar dhe konkrete të implementimit të dispozitave ligjore në fushën e vetëqeverisjes lokale që rregullojnë mekanizmat e demokracisë lokale. Kjo analizë synon të vlerësojë efektivitetin dhe ndikimin e mekanizmave të pjesëmarrjes së qytetarëve, transparencës, dhe instrumenteve të tjera demokratike në funksionimin e komunave. Raporti synon të identifikojë arritjet, sfidat, dhe mundësitë për përmirësim në përdorimin

e këtyre mekanizmave, duke ndihmuar në hartimin e rekomandimeve për avancimin e demokracisë lokale në kontekstin kosovar. Ky vlerësim do të ofrojë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit të vetëqeverisjes lokale dhe për forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Bazuar në Manualin për Vlerësimet Ex-Post, dhe të dhënave paraprake në lidhje me zbatimin e mekanizmave të demokracisë lokale, Grupi Punues ka vendosur që raporti të bëjë dy lloje të vlerësimeve: 1. vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë, dhe 2. vlerësimin e performancës. Është me rëndësi të sqarohet se këto dy vlerësime janë bërë përshtatshëm për dispozitat e caktuara që janë në fushëveprimin e raportit. Rrjedhimisht, për disa dispozita nuk është e mundur të bëhet vlerësimi i performancës, për mungesë të zbatimit nga komunat.

Për qëllim të kësaj analize ex-post të Ligjit, Grupi Punues ka definuar këtë fushëveprim të analizës këto dispozita ligjore:

a. Informimi dhe konsultimi publik (neni 68)

Dispozitat e nenit 68 të LVL-së, përcaktojnë të drejtën e qytetarëve për të qenë të informuar, për të qenë prezent në takime publike si dhe për t'u përfshirë aktivisht në politikbërje dhe vendimmarrje. Ato gjithashtu, përcaktojnë obligimin e komunës në mbajtjen e takimeve periodike obligative, si dhe takimeve konsultative të fokusuar, duke udhëzuar nxjerrjen e akteve nënligjore të cilat rregullojnë procedurat dhe format e këtyre takimeve. Për më tepër, ky nen përcakton të drejtën e qytetarëve për qasje në në dokumentet zyrtare në referencë të Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare.

b. E drejta e Peticionit (neni 69)

Neni 69 përcakton që "Çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur më përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton peticionin në pajtim më statutin dhe rregulloren e punës".

c. Iniciativa e qytetarëve (neni 70)

Neni 70 përcakton të drejtën e qytetarëve për të ndërmarrë iniciativa dhe propozuar rregullore brenda kompetencave të komuës, sipas kriterit që propozimi të "nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar". Kuvendi i komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

d. Referendumi (neni 71)

Neni 71 përcakton të drejtën e qytetarëve që të “kërkojnë që rregullorja e kuvendit të komunës e miratuar nga kuvendi i komunës, t’i nënshtrohet referendumit. Kërkesa duhet t’i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesëve të regjistruar. Kuvendi i komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të petitionit, në pajtim me ligjin në fuqi”.

e. Largimi i kryetarit (neni 72)

Neni 72 njeh të drejtën e qytetarëve për të ndërmarrë iniciativë për largimin e kryetarit, duke i paraparë dy stade në këtë proces: iniciativën e largimit si kusht paraprak dhe votimin.

f. Komitetet konsultative (neni 73)

Neni 73 ka përcaktuar të drejtën e komunës për të themeluar komitete konsultative këshilldhënëse sektoriale me qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

g. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane (neni 34)

Neni 34 përcakton të drejtën që fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane me aprovimin e komunës të vetë apo në mënyrë të kombinuar, mund të kryejnë aktivitete që bëjnë pjesë në përgjegjësitë dhe në kompetencat e komunës. Po ashtu ky nen përcakton format e bashkëpunimit me komunën, ndërsa udhëzon ministrinë për rregullimin e kësaj fushe me legjislacion sekondar.

Periudha e vlerësimit përfshinë hyrjen në fuqi të LVL e deri në datën e hartimit të këtij raporti. Megjithatë, në mungesë të të dhënave historike të zbatimit dhe efektivitetin e dispozitave nën vlerësim, vlerësimi bazohet në të dhënat e qasshme, që përfshijnë periudhën prej vitit 2018 e deri në kohën kur është hartuar ky raport.

II. PËRSHKRIMI I LIGJIT QË DO TË VLERËSOHET DHE METODOLOGJIA E ZBATUAR

Grupi Punues ka përcaktuar se qëllimi kryesor i vlerësimit ex-post të dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në veçanti atyre që lidhen me mekanizmat e demokracisë lokale, është të konstatohet nëse këto dispozita janë të zbatueshme dhe nëse institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit kanë ndërmarrë hapa konkrete për lehtësuar zbatimin e tyre.

Ky vlerësim është realizuar në përputhje me udhëzimet e Manualin e Qeverisë për Vlerësimin Ex-post të Akteve Juridike në Republikën e Kosovës. Fokusi i vlerësimit ka qenë identifikimi i mënyrës se si dispozitat e LVL janë zbatuar në praktikë dhe nëse janë hartuar aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e LVL. Gjithashtu, është analizuar ndërtimi i mekanizmave që mundësojnë zbatimin e tyre në mënyrë efektive dhe monitorimit.

Pas përcaktimit të dispozitave, grupi ka identifikuar treguesit matës dhe metodat e mbledhjes së të dhënave për të nxjerrë përfundime të vlefshme. Për të marrë një pasqyrë më të qartë të zbatimit të dispozitave të LVL që rregullojnë demokracinë lokale, dhe të dhënave nga komunat është hartuar dhe shpërndarë më komunat një pyetësor. Në anën tjetër, janë konsultuar raporte, analiza, të dhëna zyrtare dhe publike që ndërlidhen me zbatimin e dispozitave ligjore që janë pjesë e analizës ex-post.

Për këtë raport ex-post janë përdorur dy lloje të vlerësimit: vlerëzimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë, dhe vlerësimi i performancës.

Në lidhje me vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë, raporti fokusohet në pyetjet si në vijim: a. a janë zbatuar dispozitat e caktuara në fushëveprimin e raportit, b. nëse nuk janë zbatuar ato dispozita, cilat janë arsyet e moszbatimit dhe a ndërlidhen ato arsye me bazën ligjore, c. a janë dispozitat në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi në Kosovë, dhe d. a janë nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme për të mundësuar zbatimin në praktikë të dispozitave.

Për të arritur deri tek përgjigjet në këto pyetje, raporti ka përdorur të dhëna zyrtare të Qeverisë dhe komunave, raporte të besueshme ndërkombëtare, si dhe pyetësor me komuna.

Në lidhje me vlerësimin e performancës, raporti fokusohet në tregues të caktuar për secilën dispozitë konkrete që është në vlerësim. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se rezultatet e pritura janë hartuar në kontekstin e fushës që rregullojnë, në mungesë të

një dokumenti (koncept-dokumenti apo dokumenti tjetër të politikave) që ka përcaktuar objektivat apo rezultatet e pritura para miratimit të LVL.

Burime kryesore të të dhënave për këto tregues janë raportet zyrtare të MAPL, duke përfshirë këtu Raportin e Performancës së Komunave që është derivat i Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Komunave të MAPL. Ky mekanizëm përbën një mjet shumë të rëndësishëm dhe të vyeshëm të monitorimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi për vetqeverisje lokale nga ana e komunave, e në veçanti mbulon shumë prej dispozitave që janë pjesë të fushëveprimit të këtij raporti. Përveç raporteve të performancës, janë shfrytëzuar edhe raporte të tjera zyrtare të MAPL, komunave, Komisionit Evropian, dhe organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

III. REZULTATET E VLERËSIMIT

III. 1. Identifikimi i sfidave apo efekteve pozitive gjatë zbatimit të dispozitave në lidhje me informimin publik dhe konsultimeve publike

Qeverisja lokale në Kosovë ndjek me përkushtim parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Transparenca, si një nga parimet kryesore të qeverisjes lokale, sjell shumë përfitime, duke përmirësuar llogaridhënien e institucioneve lokale, rritur pjesëmarrjen publike, përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes dhe shtuar efektivitetin e përgjithshëm të administratës.

LVL, përkatësisht neni 68, ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë: Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë; Konsultimet për projektakte dhe dokumente të politikave; formave të tjera të konsultimeve të përcaktuara me akte nënligjore. Po ashty, ky ligj i obligon komunat që qytetarët t'i mbaj të informuar rregullisht për aktivitetet e saja, planet apo cfarëdo lloj programi të rëndësishëm dhe me interes publik.

Raporti ka bërë dy vlerësime të kësaj dispozite, vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë dhe vlerësimin e performancës. Vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë fokusohet në këto çështje: 1. a janë zbatuar dispozitat e caktuara në fushëveprimin e raportit, 2. nëse nuk janë zbatuar ato dispozita, cilat janë arsytet e moszbatimit dhe a ndërliken ato arsye me bazën ligjore, 3. a janë dispozitat në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi në Kosovë, dhe 4. a janë nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme për të mundur zbatimin në praktikë të dispozitave. Ndërkaq, vlerësimi i performancës bazohet në treguesit përshtatshëm me dispozitat përkatëse ligjore.

Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë

Ligji për Vetëqeverisjes Lokale ka vendosur një nivel minimal të standardeve për organizimin e takimeve gjithëpërfshirëse me qytetarët. Kjo është bërë me qëllim të ruajtjes së një komunikimi të vazhdueshëm me qytetarët, duke marrë parasysh faktin se periudha kohore nga marrja e mandatit deri te zgjedhjet e ardhshme është interval relativisht i gjatë kohor. Një arsye tjetër për zhvillimin e këtyre takimeve është që politikatat dhe proceset e vendimmarrjes të mbështeten në informacionin aktual, duke siguruar kështu që investimet të shpërndahen në formë të drejtë dhe në ato zona ku ndërhyrjet janë të nevojshme dhe afatgjata. Standardi bazë sipas paragrafit 1 të nenit 68 është mbajtja e së paku dy (2) takimeve publike brenda vitit, në të cilat mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në komune.

Ky rregullim është zbrërthyer me tej përmes akteve nënligjore të nxjerra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit dhe Lokal (MAPL), ku janë përcaktuar kriteret për kohën kur duhen organizuar këto takime, rregullat e njoftimit dhe personat zyrtarë të domosdoshëm që duhet të marrin pjesë në emër të komunës, rregullat e drejtimit të tyre, mënyrën e pranimit të propozimeve dhe kthimit të përgjigjeve nga komuna si dhe rregullat e dokumentimit të pjesëmarrësve. Pra, në raport me vlerësimin e zbatimit dhe pajtueshmërisë, kjo dispozitë e ligjit që rregullon takimet publike rezulton që baza juridike ekziston dhe rregullon në mënyrë të qartë obligimet e komunave për organizimin e takimeve publike.

Në raport me vlerësimin e performancës, rezulton se komunat kanë sfida në raport me përmbushjen e obligimeve për mbajtjen e dy takimeve publike dhe nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në këto takime publike.

Në përgjithësi, komunat ndjekin planifikimin e takimeve publike me qytetarë, megjithatë, janë evinduar mangësi në lidhje me efektshmërinë e tyre dhe pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në këto ngjarje. Të dhënat tregojnë se jo të gjitha komunat arrijnë të mbajnë dy (2) takimet e kërkuara me ligj. Informimi për këto takime bëhet përmes Zyrës Komunale për Komunikim Publik. Për të ndikuar në zbatimin e plotë të normës ligjore në fjalë, kjo çështje është përfshirë edhe në nivel të treguesit në Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale. Bazuar në Raportin e Performancës për vitin 2021, ky obligim ishte përmbushur në shkallën prej 68% nga komunat¹.

Sfidë mbetet mungesa e interesimit të qytetarëve për të marrë pjesë në takimet e organizuara, përfshirë ato me tema të veçanta. Sipas të dhënave zyrtare “pjesëmarrja mbetet e ulët edhe përkundër standardit të SMPK-së të 3% të popullsisë së komunës, i cili në vitin 2021 ishte përmbushur në shkallën 21.91% krahasuar me vitin 2020 që ishte 16.45%². Këtë pjesëmarrje të ulët e konfirmojnë edhe përgjigjet e komunave në pyetësinë e përgaditur për këtë analizë. Shumica e komunave deklarojnë se ka një interesim të ulët të qytetarëve për takimet publike të organizuara nga komuna. Një pjesë e komunave këtë e arsyetojnë me faktin se komuna adreson në vazhdimësi kërkesat e qytetarëve. Në anën tjetër, një pjesë e komunave vlerësojnë se takimet e drejtpërdrejta me qytetar të kryetarit të komunës të cilat i mbanë në periudha të shpeshta gjatë muajit mund të rezultojnë në një pjesëmarrje më të ulët të qytetarëve në takime të tjera publike. Nga 18 komunat që kanë marrë pjesë në pyetësor përmes përgjigjeve, 5 nga këto komuna kanë raportuar takimet e drejtpërdrejta me qytetarë si formën më të ndjekur të komunës për takime publike.

¹ MAPL, Raport i Performancës së Komunave për vitin 2021, Prishtinë, 2022, fq. 44.

² Po aty, fq. 28.

Formati i takimeve publike kërkon prezencën e përfaqësuesve më të lartë të ekzekutivit të komunës, duke përfshirë: Kryetarin e komunës apo përfaqësuesin e tij³. Përveç kësaj, Ligji obligon përfaqësuesit komunal që të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës, ndërsa këtyre të fundit u jep të drejtën e parashtrimit të pyetjeve (neni 68, par. 3). Kjo dispozitë është zgjeruar përmes Udhëzimit Administrativ për Transparencë të MAPL-së, duke përcaktuar detyrime shtesë për komunën përkitazi me mënyrën e kthimit të përgjigjeve. Kësisoj, nëse në pyetjet e parashtruara përfaqësuesit e komunës nuk mund të japin përgjigjet përkatëse, rregullat udhëzojnë në kthimin e përgjigjeve me shkrim brenda 30 ditëve. Udhëzimi Administrativ për Transparencë kërkon mbajtjen e procesverbaleve për çdo takim të mbajtur së bashku me evidencën e pjesëmarrësve. Të gjitha komunat që kanë marrë pjesë në pyetësorin e kësaj analize kanë deklaruar se mbajnë procesverbal të takimeve publike. Megjithatë, në ueb-faqet e komunave në fare pak raste mund të haset ndonjë procesverbal i publikuar i takimeve publike.

Marrë për bazë kompozicionin e komunave në Kosovë si në aspektin gjeografik ashtu edhe në atë demografik, standardi prej dy (2) takimeve të obligueshme, nuk është njësoj i realizueshëm, e përveç kësaj as i mjaftueshëm. Kjo duket e arsyeshme për shkak të dallimeve midis komunave, ku për një komunë me territor të madh dhe popullsi të shpërndarë siç është Podujeva, apo për Prishtinën dhe Prizrenin me densitet në zonat urbane, dy takime publike nuk do të mjaftonin për të mbledhur dhe trajtuar kërkesat e qytetarëve. Në rast të ndryshimit të LVL, është e dobishme që norma e nenit 68 të rishqyrtohet, ashtu që të marrë parasysh kriterin gjeografik dhe demografik. Në shtjellim të kësaj, është thelbësore që dispozitat e nenit 68 të marrin për bazë dallimet mes takimeve gjithpërfshirëse publike me takimet e fokusuara për projektakte, të cilat në disa raste ndodh keqkuptohen dhe të konsumojnë njëra tjetrën.

Konsultimet publike për projekt-akte dhe dokumente të politikave

Format dhe mënyrat e konsultimeve publike varen nga aktiviteti normativ i komunave. Për çdo projekt-akt normativ për të cilin LVL ose legjislacioni sektorial e kërkon, komuna është e detyruar të organizojë konsultime publike me qytetarët.

Për shkak të rëndësisë së formësimit të politikave ku qytetarët dhe grupet e interesit mund të përfshihen aktivisht, MAPL si dhe institucione të tjera vendore dhe ndërkombëtare, janë kujdesur në ngritjen e cilësisë së rregullave juridike në përputhej me standardet e kërkuara nga Bashkimi Evropian. Përveç rregullimit juridik të LVL-së, procedurat e hartimit të akteve normative dhe dokumenteve të politikave, siç janë:

³ Udhëzim Administrativ (MPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna, neni 10.5, qasur së fundi në: <https://mapl.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2020/12/0-761-2020-03.12.2020.pdf>.

Statuti, Rregulloret, apo dokumentet tjera si Planet hapësinore komunale, Strategjitë e shumta, vendime të karakterit financiar si Buxhetin, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, etj., për të gjitha këto janë paraparë rregulla specifike me Udhëzimet Administrative të MAPL-së, si dhe rregulloret komunale për transparencë.

Dhjetë vite pas hyrjes në fuqi të LVL, në dhjetor të vitit 2018, MAPL miratoi Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna⁴. Deri në hyrjen në fuqi të këtij UA, nuk ka pas ndonjë bazë juridike që ka rregulluar konsultimet publike për aktet e komunës.

Standardet minimale të konsultimeve publike në komuna u përshtatën plotësisht me parimet e Komisionit Europian (KE) për standardet minimale për konsultimin e palëve të interesuara, të aprovuara në vitin 2002⁵, si dhe Letrën e Bardhë të KE-së (2001)⁶ përmes së cilës sygjerohet të krijohet një kulturë e gjerë e konsultimit dhe komunikimit me qytetarë. Këto norma kishin për synim të adresonin disa nga problemet kryesore që ndikonin në pjesëmarrjen e qytetarëve, me qëllim që sistemi të garantonte: a) Ofrimin e dokumenteve të qarta për konsultim; b) Konsultim me të gjitha grupet relevante të synuara; c) Lejimin e kohës së mjaftueshme për pjesëmarrje; d) Publikimin e rezultateve dhe informimin e pjesëmarrësve me rezultatet e komenteve të tyre.

Rezultatet e këtyre rregullave u vlerësuan pozitivisht edhe në Raportin e KE-së për Kosovën (2020), ndërsa dispozita të caktuara u fuqizuan edhe nga institucione të tjera, siç është Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), por edhe nga organizatat donatore me anë të Grantit për Performancë Komunale. Për më saktë, ZQM lehtësoi qasjen e komunave në Platformën Qeveritare për Konsultime Publike, ashtu që krijoi një menu të veçantë për secilën komunë, në mënyrë që projekt-aktet komunale të publikoheshin në këtë platformë ku qytetarët mund të japin propozimet e tyre.

Në bazë të rregullave të tanishme, procesi i konsultimeve publike ndahet në tri stade: 1. Planifikimi i Konsultimeve; 2. Mbajtja e Konsultimeve; dhe 3. Komunikimi i Rezultateve.

Planifikimi i konsultimeve parashihet të ndodh që në fazën e hershme gjatë hartimit të planit të punës së komunës për vitin e ardhshëm kalendarik, si dhe me rastin e hartimit të planit për komunikim publik. Planifikimi i konsultimit merr për bazë afatet kohore, kostot financiare, resurset njerëzore, indentifikimin e palëve të përfshira në procesin e

⁴ Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna, qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18425>.

⁵ European Commission: "Commission of the European Communities - Towards a reinforced culture of consultation and dialogue - General principles and minimum standards for consultation of interested parties by the Commission", Brussels, 2002, fq. 21.

⁶ European Commission: "European Governance A White Paper" Brussels, 2001, fq. 16.

konsultimit publik, si dhe format dhe teknikat e konsultimit publik. Përkundër synimit të hartuesit që procesin e konsultimeve publike ta fuqizoj nga stadi fillestar i planifikimit, këto dispozita nuk kanë gjetur zbatim në praktikë.

Mbajtja e konsultimeve është faza kryesore e implementimit të planit të konsultimeve publike. Rregullat procedurale përcaktojnë obligimin që “para aprovimit të një projektpropozimi, organi propozues vendos për hapjen e procesit të konsultimit publik”⁷. Organi propozues apo drejtoria përkatëse e komunës, zgjedh format dhe teknikat e konsultimit publik të parapara me udhëzim administrativ, duke përfshirë në çdo rast 4 format obligative: 1. Konsultimin me shkrim dhe elektronik; 2. Publikimin në Platformën e qeverisë për konsultime publike; 3. Publikimi në ueb-faqen zyrtare të komunës; 4. Së paku një takim publik konsultativ me palët e interesuara”.

Të gjitha çështjet tjera organizative, përfshirë publikimin e njoftimit, mbajtjen e procesverbalit, mbledhjen e komuniteteve, komunikimin me qytetarë duhet t’i kryej zyrtari/zyra për komunikim publik në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projektaktit⁸. Sa i përket zbatimit formave dhe teknikave obligative të konsultimeve publike, përveç mbajtjes së takimeve të drejtpërdrejta me qytetarë, format e tjera alternative vijnë në shprehje më rrallë. Edhe pse komunave u është rekomanduar të zbatojnë konsultimet publike në pajtim me nenin 7 të UA Nr. 06/2018, përveç takimeve konsultative për projektakte, format dhe teknikat e tjera të konsultimeve janë praktikuar shumë më pak. Megjithatë, nga viti 2022 komunat filluan të aplikojnë konsultimin elektronik përmes Platformës Qeveritare të Konsultimeve Publike, ku edhe i’u mundësua qasja në këtë sistem. Aktualisht, të dhënat në këtë platformë tregojnë se e njëjta përgjatë viteve 2022-2023 është shfrytëzuar nga 23 komuna⁹. Nga format e normuara të konsultimeve publike, më së shpeshti është aplikuar ajo e takimeve të drejtpërdrejta me qytetarë, ndërsa ato përmes komunikimit elektronik ende nuk janë në nivel të standardizuar.

Sa i përket konsultimit të projektakteve të obligueshme, Raporti i Performancës së Komunave i vitit 2021 tregon për një nivel prej 67% të akteve në proces të hartimit janë konsultuar me publikun. Komunat më mirë qëndrojnë në dëgjimet buxhetore, ku në po këtë vit në “36 komuna kishin mbajtur 280 takime me qytetarë për projektbuxhetin, apo

⁷ Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 13.

⁸ Sipas Draft-Udhëzimit Administrativ për Transparencë dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve në Qeverisje Lokale (2023), kjo përgjegjësi i takon zyrtarit të cilin me vendim e cakton Kryetari i komunës.

⁹ Nga gjurmimi i drejtpërdrejtë i Platformës Qeveritare për Konsultime Publike, <https://konsultimet.rks.gov.net/institutions.php>.

mesatarisht 8 takime për komunë¹⁰. Edhe ky raport nënvizon prezencë të ulët të qytetarëve në këto konsultime publike, ku në total ishin raportuar 27,423 qytetarë të kenë marrë pjesë në proceset e konsultimeve publike, apo 760 qytetarë janë konsultuar për komunë. Megjithatë, për disa komuna si: Suhareka, Vitia, Skenderaj, Obiliq dhe Pejë, raporti nënvizon pjesëmarrje të kënaqshme krahasuar me numrin e popullsisë së tyre. Mirëpo, krahas aspektit kuantitativ të prezencës qytetare, raporte të institucioneve kredibile theksojnë për cilësi të dobët të konsultimeve publike, përfshirë edhe vlerësimet e dhëna nga Komisioni Evropian në raportet e rregullta për Kosovën¹¹.

Komunikimi i rezultateve është faza e fundit e procesit të konsultimit publik. Komunikimi është i rëndësishëm për shkak se informon qytetarët për komentet e tyre, nëse të njëjtat janë shqyrtuar, aprovuar apo refuzuar nga organet vendimmarëse, duke përfshirë dhënien e arsyeve për mospranimin e tyre. Kështu, në bazë të rregullave të konsultimit publik, “komuna është e obliguar të shpallë rezultatet e procesit të konsultimit publik, të publikojë raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe të japë sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo grupeve të tjera të interesuara”¹². Gjithashtu, organi propozues është i obliguar, që raportin e konsultimit publik ta paraqesë në kuvendin e komunës para aprovimit të projektpropozim, që nënkupton faktin se zbatimi i këtyre standardeve është kusht procedural për një akt të komunës për t’u cilësuar i ligjshëm.

Komunikimi i rezultateve të procesit të konsultimit publik është vlerësuar tejet i rëndësishëm. Ky proces mund të përbëjë një ndër faktorët motivues që qytetarët të jenë më aktiv nëpër këto takime. Për këtë arsye kjo çështje është ngritur edhe në nivel të treguesve të Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK), madje si tregues i veçantë në Rregullat e Grantit për Performancë Komunale. Megjithkëtë, publikimi i rezultateve të konsultimeve publike përmes një raporti kthyes, nuk është duke u përmbushur nga komunat. Të dhënat e performancës në këtë tregues për vitin 2019, tregojnë për 0% të zbatimit, kurse raporti për vitin 2021 jep rezultatin prej 4.65% të përmbushjes së këtij kriteri.

Së këndejmi, perspektiva të ndryshme, përfshirë komentet e pranuar nga komunat pjesëmarrëse në pyetësorin për këtë analizë japin arsyet e mospjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike dhe procese të konsultimit. Disa nga shkaqet më me ndikim në nivelin e ulët të pjesëmarrjes, mund të konsiderohen:

¹⁰ Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2021, MAPL, fq. 18.

¹¹ Raporti i progresit 2019, fq 10, <https://integrimievropian.rks-gov.net/raporti-i-progresit-2019>.

¹² Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neni 5.

- a. Mungesa e informimit të duhur të qytetarëve për rëndësinë e konsultimeve;
- b. Organet komunale mund të mos e kuptojnë sa duhet rëndësinë dhe përparësitë e pjesëmarrjes së qytetarëve;
- c. Mund të mos jetë shumë e qartë se kush duhet të konsultohet;
- d. Mund të mos aplikohen forma dhe teknika të përshtatshme për konsultime publike, duke i përshtatur ato diversitetit të shoqërisë;
- e. Komuna mund të jetë në presion të kohës dhe si rrjedhojë të neglizhojë këtë proces apo të synojë ta kalojë vetëm formalisht;
- f. Proceset e konsultimit kanë kosto buxhetore, kërkojnë kohë dhe angazhim të stafit komunal për organizimin e takimeve, mbledhjes dhe shqyrtimit të komenteve, hartimit të raporteve si dhe komunikimit të rezultateve të konsultimeve;
- g. Mungesa e një planifikimit më të mirë të konsultimeve.

Në analizim të përmbajtjes së dispozitave ligjore të kësaj fushe, qëndron supozimi se normativa juridike është mjaft mirë e konsoliduar, si dhe në përputhje me rregullat dhe parimet e Bashkimit Evropian. Në të ardhmen, efektet e dëshiruara të këtyre normave mund të ndikohen me anë të politikave afirmative si nga niveli qendror ashtu edhe nga ai lokal, mjeteve stimuluese siç është Granti për Performancë Komunale, vetëdijësimin të qytetarëve, riorganizimit të resurseve dhe ngritjes së kapaciteteve të tyre, promovimit të qeverisjes elektronike etj. Kjo e fundit madje veçohet në raportin e KE-së për Kosovën për vitin 2022, sipas të cilit “është shënuar një progres i lehtë në mbajtjen e konsultimeve online në nivel lokal¹³.

Informimi për aktivitetet e komunës


Krahas obligimit për së paku dy takimeve të rregullta dhe gjithpërfshirëse me qytetarë, LVL në paragrafët pasues të nenit 68 ka përcaktuar obligimin për informimin e qytetarëve planet apo programet me rëndësi për interes publik. Udhëzimet Administrative të hartuara nga MAPL, por edhe legjislacioni sektorial, kanë normuar që këto forma të informimit të qytetarëve të mundësohen me anë të: takimeve publike konsultative, dëgjimeve buxhetore, komunikimeve me shkrim dhe në formë elektronike, shfrytëzimit të ueb-faqeve zyrtare, tabelave të shpalljeve, rrjeteve sociale, etj. Këto forma del se janë ndjekur edhe nga komunat pjesëmarrëse në pyetësinë e kësaj analize.

Sigurisht që informimi dhe transparenca janë kusht për një qeverisje të mirë dhe demokratike. Transparenca e komunës implikon publikimin e informacionit dhe zhvillimin e veprimtarisë së institucioneve në një mënyrë të hapur ndaj publikut. Qasja e

¹³ Komisioni Evropian, *Raporti për Kosovën 2022*, Brussels, 2022, <https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/11/Kosovo-2022-Report-SQ.pdf>, fq. 11.

lirë në informacion luajnë një rol kyç në promovimin e transparencës dhe parandalimin e korrupsionit. Në këtë drejtim, llogaridhënia e komunave fuqizohet duke shfrytëzuar platformat online të informimit, ku më kryesorja është ueb-faqja zyrtare e komunës. Përveç si mjet që mundëson publikimin e informatave dhe dokumenteve zyrtare, ueb-faqet e komunave tani mundësojnë transmetimin online të mbledhjeve të kuvendeve të komunave. Bazuar në Udhëzimin për Transparencë, komunat janë të obliguara që të ofrojnë informacione dhe të publikojnë dokumentet si vijon: aktet e aprovuara, rregulloret, vendimet, planet, strategjitë, buxhetin, aktivitetet e prokurimit, informatat për shërbime, organizimin e komunës, të dhënat për shërbime, raportet vjetore të institucionit, aktivitetet e përditshme, etj.

Monitorimi i kësaj fushe është më i efektshëm përmes SMPK, si në aspekti i numrit të treguesve, ashtu edhe për nga saktësia e të dhënave. Sipas raporteve zyrtare të performancës, transparenca komunale përgjithësisht mbahet me një përqindje më të lartë. Sipas të dhënave për vitin 2019, në këtë fushë komunat kanë arritur 72.2% të përmbushjes së treguesve¹⁴, kurse dy vite më pas komunat kishin shënuar rënie të lehtë në 66.92%¹⁵. Nga treguesit kryesor të kësaj fushe, transmetimi i mbledhjeve online ishte arritur në shkallën 45.95% të rasteve, publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit në shkallën 74.81%, publikimi i dokumenteve të prokurimit në shkallën 82%, publikimi i akteve të miratuara nga kuvendi i komunës në shkallën 86.04%, kurse publikimi i akteve të kryetarit në shkallën 84%.




¹⁴ Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2019, MAPL, fq. 16.

¹⁵ Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2021, MAPL, fq. 19.

¹⁶ Të dhënat në tabelë janë marrë nga Raportet e Performancës së Komunave 2019, 2020, dhe 2021.

Dispozita të veçanta të LVL-së nënvizojnë përgjegjësinë e komunave për të ofruar transparencë gjatë aktiviteteve të kuvendit të komunës dhe komiteteve. Paragrafi 1 i nenit 45 të LVL-së, përcakton që “Takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion. Anëtarëve të publikut u lejohet pjesëmarrja në takime të kuvendit të komunës, ashtu siç është paraparë në Rregulloren e punës”. Më tej ky nen përcakton edhe situatën kur publiku mund të përjashtohet nga mbledhjet e kuvendit, duke nënvizuar në mënyrë eksplicite rrethanat që e lejojnë këtë gjë (neni 45, par. 3).

Në përgjithësi, korniza juridike trajton mjaftueshëm këtë çështje. Transmetimi i mbledhjeve të kuvendit është rregulluar edhe me Udhëzimin Administrativ për Transparencë, ndërsa monitorimi i tyre nga MAPL rregullohet me Udhëzimin Administrativ (MAPL) 01/2019 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative “Teleprezencave”. Këto udhëzime administrative, krahas ueb-faqeve zyrtare, udhëzojnë në përdorimin e mjeteve alternative si rrjetet sociale. Megjithëse komunat kanë filluar me zbatimin e këtyre normave obligative, transmetimi në kohë reale mbetet në nivel jo të dëshirueshëm. Sipas të dhënave të monitorimit të performancës së komunave për vitet 2019-2021, transmetimi online i mbledhjeve të kuvendit në kohë reale ishte zbatuar në nivel prej 45.95%, ndërsa në vitin 2019 ajo shprehej në 59.13%.



Megjithëse ueb-faqet janë dizajnuar sipas një strukture unike në vitin 2018, vlerësimi i përgjithshëm i funksionimit të tyre mbetet për t'u dëshiruar. Funkzioni i tyre është kryesisht i llojit informativ, ndërsa mungon aspekti interaktiv siç ishte planifikuar gjatë

¹⁷ Të dhënat në tabelë janë marrë nga Raportet e Performancës së Komunave 2019, 2020, dhe 2021.

fazës së dizajnit. Ideja e aplikimit online të qytetarëve për t'u pajisur me dokumente të ndryshme (leje, licenca) nuk është implementuar ndonjëherë. Për më tepër, problemet shtohen me sistemimin e informacioneve në ueb-faqe. Ato po ashtu janë të mangëta në instrumentet e kërkimit të dokumenteve, ku mungojnë filtrat kërkues, ndërsa një pjesë e tyre publikohen në formatin PDF scan, i cili pamundëson përpunimin e lehtë të informacionit.

E drejta për qasje në dokumentet zyrtare

E drejta për qasje në dokumente publike është një aspekt thelbësor i sistemit demokratik, dhe në shumicën e vendeve, përfshirë edhe Kosovën, është e garantuar me Kushtetutë.

Shumë shtete këtë të drejtë e kanë të inkorporuar në kushtetutat e tyre, që qytetarët, grupet e interesit, shoqëria civile dhe subjekte të tjera mundësojnë të kenë qasje në dokumentet zyrtare, me përjashtim të rasteve kur kjo qasje është e kufizuar me ligj. LVL përmban një normë blankete lidhur me të drejtën e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare. Lidhur me këtë, par. 5 i nenit 68 të LVL-së përcakton që: “Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare”. Edhe në Udhëzimin Administrativ për Transparencë është trajtuar kjo çështje, mirëpo rregullimi i hollësishëm është bërë përmes Ligjit Nr. 06/L-084 për Qasje në Dokumente Publike.

Në shtjellim të kësaj, ky ligj mbështetet në nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila garanton të drejtën e çdo personi fizik dhe juridik për të pasur qasje, pa diskriminim të çfarëdo natyre, pas një aplikimi paraprak, në dokumente zyrtare që ruhen, që hartohet ose pranohen nga institucionet publike

Bazuar në këtë, komuna, përmes zyrës komunale për komunikim publik ka detyrimin të lejojë qasjen në dokumentet e saj zyrtare për qytetarët pa diskriminim. Me qëllim të lehtësimit të procedurave për qasje në dokumentet publike, të gjitha institucionet publike, duke përfshirë edhe komunat, janë obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente.

Kërkesën për qasje në dokumente publike qytetarët mund ta paraqesin në çfarëdo mënyre, e cila i mundëson institucionit publik të identifikojë dokumentin dhe nuk janë të obliguar të japin arsye për të pasur qasje në dokumente. Institucionet publike janë të obliguara që në afat brenda shtatë (7) ditëve prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të nxjerrë vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuesin për të drejtën që

ai ka për të kërkuar rishqyrtimin e kërkesës si dhe kur dhe ku të paraqitet kërkesa e tillë¹⁸. Po ashtu, me këtë ligj të gjitha institucionet publike obligohen që t'i publikojnë të gjitha dokumentet dhe të kenë një adresë zyrtare të postës elektronike për komunikim me publikun.

Ligji shtjellon edhe kuptimin e termit 'dokument publik'. Sipas nenit 3, par. 1.3. "dokument publik" nënkupton çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik.

Në parim, ekziston një ndërlidhje e madhe në mes të përmbushjes së obligimit ligjor të komunës mbi publikimin e dokumenteve dhe të drejtës së qytetarëve për qasje në dokumente publike të komunës. Pjesa më e madhe e dokumenteve të komunave janë të karakterit publik (pra mund të kenë qasje edhe pa kërkesë) dhe si të tilla këto dokumente komuna është e obliguar që në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike si dhe Udhëzimin Administrativ për Transparencën në Komuna t'i publikojë në ueb faqen e komunës.

Sidoqoftë, raportet zyrtare tregojnë për progres të shënuar të komunave në lejimin e qasjes së qytetarëve në dokumentet publike nga viti në vit. Edhe pse Raporti i Agjencisë për Informim dhe Privatësi thekson që gjatë vitit 2022 në këtë institucion ishin parashtruar 121 ankesa kundër vendimeve të komunave për qasje në dokumentet zyrtare¹⁹, trendi i shqyrtimit dhe lejitimit të kërkesave të qytetarëve në dokumente zyrtare ka ardhur duke u përmirësuar vazhdimisht. Kjo për shkak se, sipas të dhënave zyrtare në vitin 2017 vetëm 46% të kërkesave të parashtruara janë aprovuar²⁰, ndërsa vetëm pas një viti ky trend i ulët u rrit dukshëm në 94% të kërkesave me qasje të lejuar²¹, ndërsa në vitin 2021 në 99%²².

Pra komunat kanë shënuar një progres të konsiderueshëm në raport me zbatimin e obligimeve ligjore për ofrimin e qasjes së publikut në informata, të dhëna dhe dokumente zyrtare. Megjithatë, e drejta për qasje në dokumente publike, siç është përcaktuar edhe në LVL nënkupton edhe një rol proaktiv të komunave për ofrimin e vazhdueshëm të dokumenteve, të dhënave dhe informative publike për punën e komunës përmes

¹⁸ Ligji 06/L-084 për Qasje në Dokumente Publike, neni 12.1, qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>.


¹⁹ Raport Vjetor 2022, fq. 26, për më tepër: <https://aip.rks-gov.net/download/raporti-vjetor-i-punes-per-vitin-2021-2/?epdmdl=3442&refresh=6563323146bc01700999729>.

²⁰ MAPL, *Raport për qasjen në dokumentet zyrtare të komunave Janar-Dhjetor 2017*, Prishtinë, Mars, 2018, fq. 5.

²¹ MAPL, *Raporti i funksionimit të komunave janar-dhjetor 2018*, Prishtinë, Mars, 2019, fq. 14.

²² MAPL, *Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2021*, fq. 19.

platformave interaktive. Në këtë drejtim, komunat kanë shënuar progres më të kufizuar në publikimin proaktiv të informatave, dokumenteve apo të dhënave zyrtare. Kështu, të dhënat e MAPL për vitin 2022 tregojnë për një përqindje shumë të lartë të akteve të miratuara nga kuvendet komunale, me një përqindje prej 97%²³.



Mirëpo, në anën tjetër 32 kuvende komunale kanë publikuar procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit, nga 38 komunat²⁵. Përqindje më e ulët është vërejtur në raport me procesverbalet e komiteteve për politikë dhe financa të kuvendeve komunale. Vetëm 26% e kuvendeve komunale kanë publikuar procesverbale të mbledhjeve të komitetit për politikë dhe financa.²⁶ Në raport me ekzekutivin e komunës, vetëm 77% e komunave kanë publikuar aktet e nxjerrura nga kryetari i komunës.²⁷ Edhe më keq është gjendja në publikimin e raporteve të kryetarit të komunës, ku vetëm 60% të komunave i kanë publikuar raportet e punës së kryetarit të komunës. Një gjendje pak më e mirë është vërejtur në raport me publikimin e dokumenteve financiare, si plani buxhetor, korniza afatmesme buxhetore, etj.

Në këtë pjesë të raportit janë trajtuar me kujdes edhe dispozitat e tjera të demokracisë lokale që kanë të bëjnë me të drejtën e petitionit, iniciativave qytetare, të drejtën e referendumit lokal si dhe iniciativën për largimin e kryetarit.

²³ MAPL, *Raporti për vlerësimin e transparencës në komuna janar - dhjetor 2022*, fq. 10, qasur në: <https://mapl.rks-gov.net/ep-content/uploads/2023/04/RAPORTI-PER-VLERESIMIN-E-TRANSPARENCE-03.04.2023-Shq.-LEKTORUAR.docx>.

²⁴ Të dhënat në tabelë janë marrë nga Raportet e Performancës së Komunave 2019, 2020, dhe 2021.

²⁵ Po aty, fq. 11.

²⁶ Po aty.

²⁷ Po aty, fq. 19.

Ligji ka gjithsej 4 nene me gjithsej 11 paragraf që rregullojnë mekanizmat e lartpërmendur. Këto 4 mekanizma janë trajtuar shumë sipërfaqësisht në udhëzime administrative të MAPL-së, e si rrjedhojë edhe aplikimi i tyre nuk është praktikuar.

Miratimi i legjislacionit sekondar në fushën e transparencës komunale

Paragrafi 4 i nenit 68 të LVL-së i jep të drejtë komunës në miratimin e rregullores për transparencë komunale me fushëveprim të promovimit të punës së kuvendit të komunës dhe ekzekutivit. Ky paragraf i jep të drejtë ministrisë për përgjegjëse për qeverisje lokale të nxjerr udhëzime administrative të kësaj fushe. Mbështetur në këtë bazë ligjore, MAPL ka normuar aspekte të ndryshme të transparencës përmes udhëzimeve administrative siç janë: 1) Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe Udhëzimi Administrativ (MPL) Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna; 2) Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2019 për Monitorimin e Kuvendeve të Komunave Përmes Pajisjeve të Teknologjisë Informative “Teleprezencave”; 3) Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 03/2018 për Funksonimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë; 4) Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 03/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës; 5) Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna; 6) Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Nivel Lokal.

Ndërsa në nivel lokal, aktet nënligjore që rregullojnë aspekte të transparencës janë: Statutet e Komunave dhe Rregulloret komunale për transparencë. Në bazë të të dhënave të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, aktualisht, rregulloret për transparencë janë hartuar në 27 komuna.

Në funksion të fuqizimit të politikave të transparencës, në vitin 2020, MAPL hartoi dhe publikoi edhe dokumentin udhëzues - Doracakun për konsultimet publike në nivel lokal²⁸, me qëllim që komunat t’i orientoj për format, procedurat dhe mënyrat për të përfshirë qytetarët gjatë procesit të konsultimeve publike, si dhe që ndikimi i tyre të jetë më i lartë në pjesëmarrjen publike në të gjitha segmentet e qeverisjes lokale. Veç kësaj, në vitin 2022 MAPL hartoi edhe Model Planet e Veprimit të Komunave për Transparencë, siç përcaktohet në nenin 15 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020.

Në vitin 2023, MAPL ka nisur procesin e draftimit të Udhëzimit të ri Administrativ për Transparencë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në qeverisjen lokale, me të cilin fuzionohen në një dokument të vetëm dispozitat e Udhëzimit Administrativ për Transparencë,

²⁸ Doracakun për konsultimet publike në nivel lokal, MAPL, qasur në: <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/06/FINALEE-Manuali-ne-tri-gjuhet.pdf>.

Udhëzimit për Standardet Minimale të Konsultimit Publik, si dhe dispozita të caktuara nga udhëzimet e tjera.

III. 2. Identifikimi i sfidave apo efekteve pozitive gjatë zbatimit të dispozitave në lidhje me të drejtën e peticionit, iniciativave qytetare, referendumin dhe iniciativën për largimin e kryetarit

Për analizimin e dispozitave në lidhje me të drejtën e peticionit, iniciativave qytetare, referendumin dhe iniciativën për largimin e kryetarit është përdorur vetëm vlerësimi i zbatimit dhe pajtueshmërisë. Kjo sepse të dhënat paraprake determinojnë që ka pengesa në zbatimin e dispozitave në fjalë, dhe në praktikë disa nga këto mekanizma nuk janë zbatuar fare.

E drejta e peticionit

E drejta e peticionit nënkupton një mënyrë të përbashkët për qytetarët dhe organizatat të prezantojnë dhe të kërkojnë ndryshime, veprime, ose reagime nga autoritetet e komunës. LVL në nenin 69 përcakton që “çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtën e prezantimit të peticionit në kuvendin e komunës për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi i komunës shqyrton peticionin në pajtim me statutin dhe rregulloren e punës”.

Mirëpo, për dallim nga dispozita ligjore e mësipërme, Udhëzimi Administrativ për Transparencë e ‘ngushton’ të drejtën e peticionit duke e normuar taksativisht për çështjet në kompetencë të kuvendit të komunës që kanë të bëjnë me: Rregullimin e qytetit; Miëmbajtjen e rendit dhe infrastrukturës së komunës/qytetit; urbanizimin e qytetit dhe të fshatit; mirëmbajtjen e mjedisit jetësor; zbatimin e vetëkontrollit dhe çështje të rëndësishme për jetën e pupullatës vendore²⁹.

Kompetenca për shqyrtimin dhe vendosjen në peticion është rezervuar për Kuvendin e Komunës, si autoriteti më i lartë vendimmarrës në komunë. Sa i përket, afati për shqyrtimin e peticionit, kjo gjë nuk është specifikuar në Ligjin për vetëqeverisje Lokale, duke bërë që kjo të përcaktohet me Udhëzimin Administrativ për Transparencë Nr. 03/2020. Megjithatë, në këtë udhëzim, afati është thirrë gabimisht në referencë të neneve 69 dhe 70, të cilat nene nuk përcaktojnë asnjë afat për peticionin, por këtë afat e njohin për instrumentin e iniciativave qytetare. Mbi këtë bazë, Draf-Udhëzimi për Transparencë

²⁹ Duke marrë parasysh ‘kufizimin’ e kësaj të drejtë ndryshe nga siç parasheh LVL, në draftin e Udhëzimit të ri Administrativ për Transparencë dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve në Qeverisje Lokale (2023), kjo dispozitë është hequr në tërësi. Gjithashtu, termet si qytet, vetëkontroll etj., janë harmonizuar sipas LVL-së.

(2023), afatin prej 60 ditësh për shqyrtim të petitionit, e redukton në afat më të shkurtër kohor prej 30 ditësh³⁰.

Çështje tjetër e paqartë në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 është mungesa e dallimeve konceptuale në mes të petitionit si instrument i veçantë juridik, nga iniciativa qytetare e cila është specifike për propozimin e rregulloreve sipas nenit 70.1 të LVL-së, duke shkaktuar kështu konfuzion në zbatimin e tyre. Duke parë këto paqartësi, diferencimi i tyre është bërë në Draft-Udhëzimin e ri Administrativ për Transparencë, ku janë trajtuar ndaras nga njëra-tjetrës.

Sipas të dhënave të raportuara nga komunat që kanë marrë pjesë në pyetësin e kësaj analize, vetëm 7 nga 18 komunat e përgjigjura kanë raportuar se kanë pranuar peticione gjatë vitit 2022/23 apo vitet paraprake. Këto shtatë (7) komuna kanë raportuar gjithsej 13 peticione të pranuar, apo diku më pak se dy (2) peticione për komunë. Kryesisht natyra e këtyre peticioneve kishte të bënte me kërkesa pronësore apo ri-orientim i investimeve publike në lokacione të tjera të komunës. Edhe pse këto të dhëna janë të mangta për të pasur një pasqyrë të saktë të përdorimit të mjetit të petitionit nga qytetarët për të ndikuar vendimarrjen lokale, mund të nxirret përfundim i kujdesshëm se ky institut ligjor përdoret në nivel të ulët nga qytetarët.

Iniciativat qytetare

Iniciativat qytetare paraqesin instrumente specifike për shprehjen e kërkesave të qytetarëve në akte nënligjore, respektivisht në rregullore komunale. LVL në nenin 70 ka përcaktuar të drejtën e qytetarëve për të “marrë iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim. Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar kryesuesit të kuvendit të komunës”. Parakusht për aktivizimin e kësaj initiative është “nënshkrimi i së paku “15% e votuesve të regjistruar për t’u shqyrtuar nga kuvendi i komunës” (parag. 3 neni 70 i LVL-së).

Po ashtu, LVL përcakton që rregulloret e tilla duhet të jenë brenda fushëveprimit të kompetencave të Komunës, dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Procedurat udhëzojnë që qytetarët si propozues, duhet t’ia dorëzojnë draftin e rregullores të propozuar Kryesuesit të Kuvendit, në mënyrë që e njëjta të shqyrtohet brenda 60 ditëve nga data e pranimit.

Fillimisht ekziston mendimi që ky institut juridik është vështirë i aplikueshëm, për shkak të kriterit së lartë të kërkuar për marrjen e nënshkrimeve nga qytetarët. Gjithashtu,

³⁰ Draft-Udhëzimi Administrativ për transparencë dhe pjesëmarrje të qytetarëve në qeverisje lokale, neni 33 par. 5.

administrimi i procesit të mbledhjeve të nënshkrimeve nuk është sqaruar me ndonjë akt nënligjor. I paqartë mbetet edhe rregullimi sipas nenit 9 paragraf 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 për Transparencë i cili përcakton që: “pas diskutimit në kuvendin e komunës, kryetari i komunës ose shërbimi përkatës, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit njofton parashtruesin e kërkesës ose petitionit”. Kjo dispozitë nuk bënë dallimin e procedurave ndërmjet petitionit dhe iniciativave të qytetarëve, e për më tepër nuk shtjellon mënyrën e verifikimit të nënshkrimeve dhe vërtetësinë e tyre.

Në Draft-Udhëzimin Administrativ për Transparencë (2023), kjo çështje i është rezervuar kuvendit të komunës ashtu që përcaktohet se “Kuvendi inicion procesin e verifikimit të nënshkrimeve të dorëzuara; pas verifikimi kërkesat dhe iniciativat qytetarë shqyrtohen nga kuvendi i komunës në afat prej 60 ditësh siç përcaktohet me nenin 69 dhe 70 të LVL-së. Të dhënat përfshirë nënshkrimet e përfaqësuesve të iniciativës ruhen dhe arkivohen konform ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në bazë të përgjigjeve të komunave në pyetësorin e këtij raporti del se asnjë nga 18 komunat që janë përgjigjur në pyetësor nuk kanë pranuar asnjë iniciativë qytetare gjatë vitit 2023 dhe vitet paraprake. Rrjedhimisht, kjo dispozitë ka mbetur e pa zbatuar.

Iniciativa për largimin e kryetarit

Një modalitet tjetër i iniciativave të qytetarëve është ajo për largimin e kryetarit të komunës. Në bazë të LVL (neni 72), “qytetarët e komunës mund të ndërmarrin iniciativë për largimin e kryetarit të komunës. Kërkesa e tillë duhet të nënshkruhet nga njëzet (20) përqind e votuesëve të regjistruar dhe i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, i cili e paraqet çështjen në institucionin përkatës për administrimin e votimit. Nëse shumica e votuesve të regjistruar votojnë për largimin e kryetarit, zgjedhjet e reja për kryetar duhet të bëhen në pajtim me Ligjin për Zgjedhjet”.

Praktikisht zbatimi i kësaj dispozite është shumë i vështirë i arritshëm, për dy arsye kryesore: e para, nisma për largim kërkon një kuotë prej 20% të votuesve të regjistruar, e që është mjaft sfiduese për tu arritur³¹. Ndërsa e dyta, procedura e votimit për largim kërkon aprovimin e shumicës së votuesve të regjistruar e cila është e paarithshme, dhe mund të bazohet referuar numrit të votuesve që kanë votuar në zgjedhjet lokale. Si rrjedhojë, kriteri rigoroz për ndërmarrjen e nismave për shkarkim, e bënë pozitën e fortë të kryetarit të komunës, gjë që kjo ka mundur të jetë një nga faktorët për mosndërmarrjen e një iniciative për largim.

³¹ MAPL, *Studim Gjithpërfshirës i Sistemit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë*, Prishtinë, Dhjetor, 2021, fq. 57.

Prej hyrjes në fuqi të LVL, mekanizmi i iniciativës për largim të kryetarit nuk ka qenë i rregulluar më tej me legjislacion sekondar. Pas zgjedhjeve të organizuara në prill të vitit 2023 në katër komunat në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Leposavic, Zvečan dhe Zubin Potok, dhe refuzimi të komunitetit serb për pjesëmarrje në ato zgjedhje u krijua nevoja për identifikimin e mundësive për shfrytëzimit të mekanizmit të iniciativës për largimin e kryetarit të komunës. Si pasojë e diskutimeve publike në lidhje me ngjarjet që pasuan zgjedhjet në veri të Kosovës, u intensifikuan veprimet për përcaktimin e një kornize ligjore përmes nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 për Iniciativën e Qytetarëve për Largimin e Kryetarit të Komunës nga Funkzioni³². Megjithatë, deri në hartimin e këtij raporti, nuk ka pas të dhëna në lidhje me fillimin e ndonjë initiative për largimin e kryetarëve, duke u mbështetur në këtë Udhëzim Administrativ. Për më tepër, mbetet e paqartë nëse kjo bazë ligjore është e mjaftueshme për të vënë në funksion këtë mekanizëm ligjor të rëndësishëm për komunat. LVLpërkatësisht neni 72 nuk thirret në krijim e një baze nënligjore për të rregulluar tutje këtë mekanizëm. I vetmi rregullim për këtë mekanizëm përcaktohet në vet LVL. Mbetet për t'u shqyrtuar nëse një iniciativë e tillë për largimin e kryetarit, një funksion që zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë, të mund të rregullohet tutje me një akt nënligjor, apo përmes një ligji të veçantë.

Referendumi lokal

Referendumi është një mënyrë e shprehjes së drejtpërdrejtë të vullnetit të qytetarëve në lidhje me një çështje ose iniciativë të ndërmarrë. Edhe pse i garantuar me kushtetutë, në disa raste referendumi nuk është i lejuar, siç është edhe ndalesa që legjislacioni me interes vital (ku bënë pjesë LVL) t'i nënshtrohet referendumit.

Në nivel lokal, referendumi është dhënë si e drejtë, por e kufizuar vetëm në lidhje me Rregulloret e aprovuara të kuvendit. Veç kësaj, ky institut juridik nuk është bërë i qartë për nga natyra e tij juridike, përkatësisht nëse i njëjti do të jetë referendum i tipit konsultativ apo obligativ. LVL përcakton se “qytetarët e komunës mund të kërkojnë që rregullorja e kuvendit të komunës e miratuar nga kuvendi i komunës, t'i nënshtrohet referendumit”. Procedura është përcaktuar në atë mënyrë që kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të kuvendit të komunës, në afat brenda 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar. Kuvendi i komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimit të peticionit, në pajtim me ligjin në fuqi”.

³² Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2023 për Iniciativën e Qytetarëve për Largimin e Kryetarit të Komunës nga Funkzioni, qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=80975>.

Argumente të tjera theksojnë se “neni 71 nuk e bënë të qartë plotësisht nëse bëhet fjalë për rregullore të kërkuar përmes iniciativave të qytetarëve, petitionit, apo të dyjave”. Pra, kjo është dispozita e vetme lidhur me referendimet lokale, gjë që nënkupton se LVL nuk parasheh të drejtën e qytetarëve për të kërkuar mbajtjen e referendumeve lokale si mjet të pjesëmarrjes qytetare lidhur me çfarëdo çështje specifike që bie në kuadër të punëve të komunave”³³.

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 65 përcakton kompetencën e Kuvendit të Kosovës për të “shpallë referendum, në pajtim me ligjin”. Megjithatë, deri më tani nuk është draftuar asnjë ligj që rregullon shpalljen, kriteret e pjesëmarrjes, organizimin dhe formalizimin e një referendumi në Kosovë. Në mungesë të një ligji të tillë, edhe dispozita e LVL që përcakton referendumin lokal nuk ka rregullim ligjor që definon procedurën e referendimit në nivelin lokal. Gjithashtu, nuk ekziston ndonjë akt nënlidhës që përcakton procedurat për organizimin dhe mbajtjen e referendumeve, për të konkretizuar dispozitat e LVL. Megjithatë, nuk është e qartë nëse ligjërisht, çështja e referendimit lokal mund të rregullohet në nivelin e një akti administrative apo akti tjetër nënlidhës të nxjerrë nga MAPL, apo nga komunat brenda kompetencave të tyre.

Në mungesë të një kornize të plotë ligjore, deri më tani ky mekanizëm i demokracisë lokale nuk është përdorur. Nga dhënat zyrtare publike të qasshme rezulton se deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast të referendimit të organizuar në nivelin lokal në Kosovë. Për më tepër, nga përgjigjet e komunave në pyetësorin e kësaj analize, 17 komuna kanë deklaruar se nuk kanë pasur ndonjë rast të referendimit në komunat e tyre. Vetëm Komuna e Suharekës ka raportuar një rast të referendimit, mirëpo nuk është e qartë nëse është ngatërruar me ndonjë rast të petitionit apo initiative qytetare. Sipas përgjigjeve të pranuar nga Komuna e Suharekës, arsyeja e referendimit ishte një kërkesë për caktimin e lokacionit të një objekti fetar.

Miratimi i një ligji që përcakton rregullat e organizimit të referendumeve, qoftë në nivelin lokal dhe qëndror do të mundësonte zbatimin e dispozitës së LVL për organizimin e referendimit në nivelin lokal. Deri në atë moment, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme.

Komitetet konsultative

Në kuadër të mekanizmave ligjorë për përfshirje të qytetarëve në procesin e vendimmarrje janë edhe komitetet konsultative, si trupa ndihmës të Kuvendit Komunal. Këto komitete mund të themelohen për sektor specifik si: arsimit, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj. Anëtarësia e tyre është e rezervuar vetëm për qytetarët dhe përfaqësues të OJQ-ve. Qëllimi kryesor i themelimit të këtyre komiteteve është të

³³ MAPL, *Studim Gjithpërfshirës i Sistemit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë*, Prishtinë, Dhjetor, 2021, fq. 57.

shtohet pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesuara në procesin e vendimmarrjes komunale.

Baza ligjore që rregullon më në detaje themelimin, punën, organizmin dhe kompetencat e komiteteve konsultative ekziston dhe përbën bazë të mirëfilltë për funksionimin e tyre. Për këtë është miratuar Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna³⁴, i cili ka ndryshuar një udhëzim administrative paraprak që ishte në fuqi prej vitit 2008.

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2016 është përcaktuar se propozimet për themelimin e komiteteve mund të bëhet nga: a. kryetari i komunës, b. anëtarët e kuvendit, dhe c. shoqëria civile. Tutje, është paraparë edhe themelimi i komiteteve ad-hoc, për çështje të caktuara, mandati i së cilës përfundon më përfundimin e çështjes që komiteti është themeluar të trajtoj. Komiteti mund të përbëhet prej 5 deri në 7 anëtar, dhe përbërje duhet të reflektoj përfaqësimin gjinor. Përzgjedhja e anëtarëve të komiteteve konsultative zhvillohet përmes një procesi konkurrues publik, i cili shpallet nga kuvendi i komunës dhe specifikon kriteret e nevojshme për kandidatë. Mandati i anëtarëve të komiteteve konsultative ka një periudhë prej 4 vitesh nga momenti i krijimit të komitetit, dhe një anëtar i komitetit nuk mund të mbajë më shumë se dy mandate në këtë rol.

Aktualisht nuk ka të dhëna zyrtare të sakta mbi numrin e komiteteve konsultative të themeluara në komuna. Të dhënat e vitit 2019 në mënyrë përmbledhëse pasqyrojnë themelimin e këtyre komiteteve në 13 komuna, me gjithsej 35 komitete konsultative. Këto komitete janë themeluar në sektorë të qeverisjes lokale si: planifikim hapësinor, arsim, kulturë dhe sport, zhvillim ekonomik lokal, urbanizëm, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, të drejta të njeriut, barazi gjinore, bujqësi dhe emergjenca³⁵. Pra të dhënat e vetme të qasshme janë ato që publikohen nga MAPL përmes raporteve vjetore. Mirëpo, këto të dhëna janë të paqarta nëse pasqyrojnë numrin total të komiteteve konsultative të themeluara nga të gjitha komunat.

Nëse analizohet Raporti i Funksionimit të Kuvendeve të Komunave për vitin 2022³⁶, rezulton se gjatë vitit 2022 vetëm 11 komuna kanë themeluar komitete konsultative. Kjo e dhënë nuk pasqyron saktë nëse ka komitete konsultative të themeluara nga komunat e tjera gjatë viteve paraprake, apo se vetëm 11 komuna kanë të themeluara këto komitete.

³⁴ Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, qasur në: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12979>.

³⁵ MAPL, *Raport i funksionimit të komunave për vitin 2019*, fq. 10.

³⁶ MAPL, *Raport i Funksionimit të Kuvendeve të Komunave 2022*, fq. 13, qasur në: <https://mapl.rks.gov.net/ep-content/uploads/2023/07/Raporti-i-funksionimt-te-KK-2022-020-291-2023.pdf>.

Po ashtu, nuk ka të dhëna të publikuara mbi rezultatet e punës së këtyre komiteteve, prandaj nuk mund të nxjerret një konstatim i saktë mbi efektin dhe rezultatet e punës së tyre. Meqë mandati i komiteteve konsultative është 4 vjeçar me të drejtë të rizgjedhjes për një mandat të dytë³⁷, të dhënat e mësipërme për themelimin e tyre janë relative.

Sa i përket natyrës së këtyre komiteteve, LVL lë hapësirë për interpretim nëse janë të obligueshme ose jo. Për këtë arsye, jo të gjitha komunat e Kosovës kanë themeluar komitete të tilla. Vlerësohet se themelimi dhe funksionimi i këtyre komiteteve në shumicën e komunave të Kosovës ka qenë sfidues dhe nuk është arritur përdorimi i tyre i suksesshëm si mekanizëm për përfshirjen e qytetarëve qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Bazuar në të dhënat e marra nga komunat nga pyetësorët e kësaj analize, del se nga 10 komunat që kanë raportuar themelimin e komiteteve konsultative, vetëm 7 prej këtyre komunave kanë raportuar se komitetet konsultative kanë raportuar në kuvend për çështjet e trajtuar nga ato komitete. Për më tepër, vetëm 5 kanë komunat që kanë komitete konsultative të themeluara kanë raportuar se komitetet komunale kanë publikuar raporte të punës së komiteteve.

Organizata të shoqërisë civile që monitorojnë punën e komunave kanë identifikuar se disa nga arsyet e mos funksionimit të tyre ndërlidhen me “politizimin, mungesën e vullnetit dhe mungesën e njohjes së të drejtave ligjore, jo vetëm nga ana e qytetarëve por edhe nga vetë zyrtarët komunal”³⁸.

Themelimi i Këshillave të Fshatrave, Lagjeve Urbane dhe Vendbanimeve

Këshillat lokale janë trupa të zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane. Me legjislacion dytësor, komunave iu kërkohet të themelojnë numër të caktuar të këshillave lokale varësisht nga numri i banorëve³⁹. Më tej, udhëzimi administrativ vendos standardet për përbërjen e Këshillave lokale (5-9 anëtarë). Këto Këshilla kanë mandat katërvjeçar, ndërsa bashkëpunimi i komunës me këshilla përcaktohet me marrëveshje të veçantë (neni 9), ashtu që duhet të fokusohet në këto çështje: planifikimin urban dhe rural; furnizimin me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimin; shëndetësinë publike; mbrojtjen e ambientit; turizmin; hapësirat publike dhe varrezat; aktivitetet kulturore e sportive; etj. Në këtë drejtim, Kryetari i komunës dhe kryesuesi i kuvendit janë të obliguar

³⁷ Supra 31, neni 9.

³⁸ Iniciativa për Progress - INPO, *Komitetet Konsultative – në funksion të qeverisjes së mirë në Kosovë*, Ferizaj, Gusht, 2018, fq. 7, qasur në: <https://inpo-ks.org/ep-content/uploads/2018/08/Komitetet-Konsultative-final.pdf>.

³⁹ Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshtatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

të mbajnë takime me këto këshilla të paktën nga dy herë në vit. Udhëzimi administrativ ka rregulluar edhe të drejtën e kompensimit të anëtarëve të Këshillit, në një shumë ekuivalente me atë të Komiteteve të obligueshme, por që nuk mund të kompensohen më tepër se për 6 takime të mbajtura gjatë vitit.

Edhe pse korniza juridike në këtë fushë rregullon në hollësi mënyrën e themelimit, si dhe procedurat dhe të drejtat e anëtarësisë së këshillave lokale, të dhënat mbi aktivitetin e tyre flasin për vështirësi në funksionimin dhe arritjen e qëllimeve për çfarë janë themeluar. Së pari, të dhënat zyrtare tregojnë se këto këshilla nuk janë të themeluara në të gjitha komunat. Referuar të dhënave të vitit 2019, këshillat lokale janë themeluar në 26 komuna, pra pothuasje gjysma e komunave nuk kishin themeluar asnjë këshill. Më tej, raportet argumentojnë se aktiviteti i tyre nuk është në harmoni me normën minimale të mbajtjes së takimeve. Vetëm gjatë vitit 2021, kriteri ligjor që këshillat lokale t'i mbanin 6 takime brenda vitit ishte arritur në shkallën prej 37,58%⁴⁰. Sa i përket përbërjes së këshillave, vihet re mungesë e theksuar e përfaqësimit të barabartë gjinor, ku sipas të dhënave të vitit 2019, në shumicën e këtyre këshillave nuk kishte asnjë grua në rolet udhëheqëse. Ndërsa të dhënat e Raportit të Performancës së Komunave për vitin 2022 tregojnë se vetëm 6.66% e anëtarëve të këshillave lokal janë gra⁴¹. Kjo e dhënë paraqet një situatë shqetësuese të përfaqësimit të grave në këshillat lokal, edhe pse funksioni i këtyre këshillave është të përfshijë komunitetin në vendimmarje. Rrjedhimisht, pjesa më e madhe e grave mbesin të pa përfshira në proceset lokale.

Në lidhje me zbatimin e dispozitës që përcakton marrëveshjet e komunës me këshillat lokal, nga pyetësorët me komuna del se asnjë nga 18 komunat që janë përgjegjur në pyetësor nuk kanë hyrë në marrëveshje me këshilla lokal. Rrjedhimisht, kjo dispozitë ka mbetur e pazbatuar.

⁴⁰ MAPL, *Raporti i Performancës së Komunave për vitin 2021*, fq. 44.

⁴¹ Po aty, fq. 35.

IV. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Transparenca, takimet dhe konsultimet publike

- Legjislacioni në fuqi krijon bazë solide ligjore për rregullimin e takimeve publike, konsultimet publike për projektakte, dhe transparencën komunale në përgjithësi.
- Komunat përmbushin përgjithësisht obligimin e organizimit të dy takimeve me qytetarë siç kërkohet me LVL por pjesëmarrja e qytetarëve në takimet publike mbetet shumë e ulët.
- Ndonëse komunat kanë filluar të ndjekin praktika të ndryshme të takimeve me qytetarë, qoftë edhe ato përmes mjeteve elektronike të komunikimit, interesimi i qytetarëve për pjesëmarrje në këto takime nuk është rritur.
- Zbatimi i obligimeve ligjore nga komunat në lidhje me konsultimet publike për projektaktet e komunave mbetet jo i plotë. Vetëm 60% e komunave kanë përdorur platformën e publikimit të akteve komunale për konsultim publik.
- Komunat qëndrojnë shumë mirë sa i përket organizimit të takimeve për dëgjime buxhetore me qytetarë. Ka një trend shumë pozitiv të rritjes së numrit të takimeve për buxhet nëpër të gjitha komunat.
- Komunat kanë një nivel shumë të ulët të publikimit të rezultateve të konsultimit publik.
- Komunat kanë shënuar një progres të konsiderueshëm në raport me zbatimin e obligimeve ligjore për ofrimin e qasjes së publikut në informata, të dhëna dhe dokumente zyrtare.

Peticioni

- LVL nuk përcakton afate ligjore për shqyrtimin e peticioneve, ndërsa aktet nënligjore nuk trajtojnë në mënyrë specifike rregullimin e afateve për shqyrtimin e peticioneve.
- Komunat kanë pranuar numër relativisht të vogël të peticioneve në vitet e fundit.
- Në rregullimin me akte nënligjore, ka një përzierje të paqartë mes peticionit dhe iniciativave qytetare.

Iniciativat qytetare

- LVL përcakton bazë ligjore për iniciativat qytetarë, por mungon rregullimi specifik i procedurës së administrimit të iniciativës dhe shqyrtimit të tyre nga komuna.

- Administrimi i procesit të mbledhjeve të nënshkrimeve dhe verifikimi i tyre nuk është sqaruar me ndonjë akt nënligjor.
- Iniciativa qytetare si mekanizëm i pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje është vështirë i aplikueshëm, për shkak të kriterit së lartë të kërkuar për marrjen e nënshkrimeve nga qytetarët.

Iniciativa për largimin e kryetarit

- Nisma për largimin e kryetarit të komunës është praktikisht vështirë i arritshëm, për shkak të kuotës prej 20% të votuesve të regjistruar për të filluar procedurën.
- Deri në vitin 2023 nuk ka ekzistuar bazë e mjaftueshme ligjore për funksionalizimin e mekanizmit të iniciativës për largimin e kryetarit të komunës dhe ky mekanizëm nuk është përdorur në asnjë komunë.

Referendumi lokal

- Edhe pse LVL përcakton mundësinë për organizimin e referendumit lokal për çështje të caktuara, mungon korniza ligjore për organizimin e referendumeve.
- Në mungesë të një kornize të plotë ligjore, deri më tani ky mekanizëm i demokracisë lokale nuk është përdorur.

Komitetet konsultative

- Baza ligjore që rregullon më në detaje themelimin, punën, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative ekziston dhe përbën bazë të mirëfilltë për funksionimin e tyre.
- Transparenca e punës së komiteteve konsultative është shumë e ulët në të gjitha komunat.
- Sipas të dhënave të qasshme, më pak se 30% të komunanve kanë të themeluara komitetet konsultative.
- Roli i komiteteve konsultative në hartimin e politikave lokale është i limituar.

Këshillat lokal

- Themelimi, organizimi dhe mënyra e funksionimit të këshillave lokal është e rregulluar me bazë të mirëfilltë ligjore.
- Mekanizmi i këshillave të fshatrave, lagjeve urbane dhe vendbanimeve nuk është plotësisht i pranishëm tek të gjitha komunat.
- Këshillat lokal të themeluar nuk arrijnë të plotësojnë kriterin ligjor të organizimit të së paku gjashtë (6) takimeve brenda vitit.
- Gratë janë drastikisht të papërfaqësuar në këshillat lokal nëpër komuna.

V. REKOMANDIMET

Transparenca, takimet dhe konsultimet publike:

- Komunitat të avansojnë praktikën e mirë për ndërgjegjësimin e qytetarëve rreth rëndësisë së takimeve publike dhe konsultimeve përmes kampanjave të ndërgjegjësimit dhe materialeve informative.
- Komunitat të shtojnë përdorimin efikas të mjeteve elektronike për të rritur pjesëmarrjen dhe interesin e qytetarëve në takime dhe konsultime.
- Komunitat të avansojnë platformat për të publikuar informacione, dokumente dhe të dhëna zyrtare në mënyrë proaktive për të rritur transparencën dhe qasjen e qytetarëve në informacionin publik.
- Niveli qëndror të ofrojnë mbështetje dhe trajnime të vazhdueshme për komunitat për zbatimin e plotë të ligjit dhe rregullave për konsultimet publike për projektat.
- Komunitat të avansojnë përdorimin e platformës elektronike për konsultime publike në mënyrë më aktive dhe të publikojnë rezultatet e konsultimeve.

Peticioni dhe Iniciativat Qytetare:

- Të plotësohet legjislacioni sekondar për përcaktimin e afateve ligjore për shqyrtimin e peticioneve dhe të përmirësohet qartësia në rregullat e shqyrtimit të tyre nga komunitat.
- Legjislacioni sekondar të trajtojë ndaras mekanizmin e peticionit dhe iniciativës qytetare.

Iniciativat për Largimin e Kryetarit:

- Rishikimi i kuotës së nevojshme për nisjen e procedurave për largimin e kryetarit për të bërë më të lehtë pjesëmarrjen e qytetarëve.
- Zhvillimi i bazës ligjore për përcaktimin e afateve dhe procedurave për iniciativat e largimit të kryetarit.

Referendumi Lokal:

- Zhvillimi i një kornize ligjore për organizimin e referendumeve lokale dhe përcaktimi i procedurave të qarta për përdorimin e tyre.
- Niveli qëndror i qeverisjes të ofroj mbështetje ndaj komunave për të përdorur me efikasitet mekanizmat e referendumeve për të konsultuar qytetarët në çështje të caktuara.

Komitetet Konsultative dhe Këshillat Lokale:

- Të krijohen mekanizma për mbështetjen e komunave për të themeluar komitete konsultative dhe të përmirësohet transparenca e punës së komiteteve konsultative.
- Komuna të identifikoj praktika të stimulimit të pjesëmarrjes së diversifikuar në komitetet konsultative dhe këshillat lokale, duke përfshirë grupet e marginalizuara dhe grupeve të tjera minoritare.
- Komunat duhet të krijojnë mekanizma për mbështetjen administrative të punës së këshillave lokale, për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe përmbushjen e kriterit ligjor për takimet e këshillave lokale.
- Komuna të identifikoj praktika të stimulimit të pjesëmarrjes së diversifikuar për të rritur përfaqësimin e grupeve të papërfshira, përfshirë gratë, në këshillat lokale.

VI. SHTOJCA 1 – Pyetësi me komuna

Tematika	Pyetjet
Informimi publik dhe konsultimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. A mbani takime periodike (së paku dy herë në vit) publike me qytetarë? 2. Cilat forma të takimeve i realizoni? Përshkruani ndonjë formë të veçantë nëse e realizoni në komunën tuaj dhe tregoni se pse ajo formë ka sukses. 3. Si i informoni qytetarët për takimet publike? Përshkruani mjetet që përdoren për njoftimin e publikut. 4. A mendoni që këto metoda/mjete për informimin e publikut janë të mjaftueshme? 5. A mbahet ndonjë procesverbal në takimet publike ku shënohet vërejtjet, kërkesat, propozimet e qytetarëve? 6. Sa trajtohen kërkesat e qytetarve të paraqitura në takimet publike të organizuara nga komunat? 7. Shkruaj koment: Pse vlerësoni se ka interesim të vogël të qytetarëve për takimet publike.
E drejta e petitionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. A keni pranuar ndonje petition nga qytetarët gjatë vitit 2022/23 apo vitet paraprake? 2. Nëse po, sa peticione keni pranuar? 3. Nëse po, cila ka qenë natyra e tyre? 4. Nëse po, si janë trajtuar këto peticione dhe në çfarë afati i keni trajtuar?
Iniciativa e qytetarëve	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sa iniciativa qytetarë ka pasur në komunën tuaj gjatë vitit 2022-2023? 2. Sipas vlerësimit tuaj, a mendoni se përqindja e propozuar është e lartë apo e ulët? Përshkruaj arsyet e vlerësimit tuaj apo çfarëdo rekomandimi që mund të keni në lidhje me këtë temë.
Referendumi	<ol style="list-style-type: none"> 1. A ka pasur ndonjë rast kur qytetarët e komunës suaj kanë bërë kërkesë për referendum? 2. Nëse po, sa kërkesa keni pranuar dhe përshkruaj kërkesat për të cilat është kërkuar referendumi.

	3. A mendoni se është i nevojshëm një Ligj i veçantë për Referendumin?
Iniciativa për largimin e kryetarit	1. A keni pranuar ndonjëherë kërkesë për largimin e kryetarit? 2. Nëse po, si është trajtuar kjo kërkesë?
Komitetet konsultative	1. Sa komitete këshillëdhënëse aktive ka në komunën tuaj? 2. A publikohen raportet e punës se këtyre Komiteteve? 3. A raportojnë këto Komitete para Kuvendit?
Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane	1. A ka pasur komunna juaj marrëveshje me fshatra vendbanime dhe lagje urbane? 2. Nëse po, sa prej këtyre marrëveshjeve janë zbatuar plotësisht dhe sa prej tyre nuk janë zbatuar? Jep përshkrime më të detajuara nëse e vlerësoni të nevojshme. 3. Në çfarë forme Komuna ka ofruar mbështetje përmes këtyre marrëveshjeve?

Komunat të cilat kanë marrë pjesë në pyetësoin e këtij raporti janë: Komuna e Deçanit, Drenasit, Ferizajt, Fushë Kosovës, Gjakovës, Gjilanit, Graçanicës, Kaçanikut, Klinës, Mamushës, Novobërdës, Pejës, Podujevës, Prizrenit, Shtimes, Skenderajt, Suharekës, dhe Lipjanit.

VI. SHTOJCA 2 – Lista e referencave

Raporte, analiza, dokumente të tjera:

MAPL, *Raport i Performancës së Komunave për vitin 2021*, Prishtinë, 2022.

MAPL, *Raport i Performancës së Komunave për vitin 2019*, Prishtinë, 2022.

MAPL, *Raport për qasjen në dokumentet zyrtare të komunave Janar-Dhjetor 2017*, Prishtinë, 2018.

MAPL, *Raporti i funksionimit të komunave janar-dhjetor 2018*, Prishtinë, Mars, 2019.

MAPL, *Raporti për vlerësimin e transparencës në komuna janar - dhjetor 2022*, Prishtinë, 2023.

MAPL, *Studim Gjithpërfshirës i Sistemit të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë*, Prishtinë, Dhjetor, 2021.

MAPL, *Raport i Funksionimit të Kuvendeve të Komunave 2022*, Prishtinë, 2023.

European Commission, *Commission of the European Communities - Towards a reinforced culture of consultation and dialogue - General principles and minimum standards for consultation of interested parties by the Commission*, Brussels, 2002.

European Commission, *European Governance A Ehite Paper*, Brussels, 2001.

Komisioni Evropian, *Raporti i Progresit për Kosovën 2019*, Brussels, 2020.

Komisioni Evropian, *Raporti i Progresit për Kosovën 2022*, Brussels, 2023.

Agjencia për Informacion dhe Privatësi, *Raport vjetor i punës 2021*, Prishtinë, 2022.

INPO, *Komitetet Konsultative – në funksion të qeverisjes së mirë në Kosovë*, Ferizaj, Gusht, 2018.

MAPL, *Doracaku për konsultimet publike në nivel lokal*, Prishtinë, 2021.

Aktet juridike:

Ligji 06/L-084 për Qasje në Dokumente Publike

Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 02/2023 për Iniciativën e Qytetarëve për Largimin e Kryetarit të Komunës nga Funksioni.

Udhëzim Administrativ (MPL) Nr. 03/2020 për Transparencë në Komuna.

Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshtatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna.

Draft-Udhëzimit Administrativ për Transparencë dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve në Qeverisje Lokale (2023).

Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

VI. SHTOJCA 3 – Lista e shkurtesave

KE	Komisioni Evropian
LVL	Ligji për Vetqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OJQ	Organizatë jo-qeveritare
SMPK	Sistemi i menaxhimit të performances komunale
UA	Udhëzimi Administrativ
UNMIK	United Nations Mission in Kosovo
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë